

SPROVË PËR KRAHASIM MES “CIKLIT TË KRESHNIKËVE” DHE
EPOSIT SPANJOLL “KËNGA E MIO SIDIT” NË KUADËR TË HAPËSIRËS
EVROPIANE

Dr. Drita Isufaj

Departamenti i Letërsisë

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: dritaisufaj@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Ngjashmëritë ndërmjet eposeve që u përkasin vendeve të ndryshme europiane zakonisht vijnë si rezultat i kontakteve të drejtpërdrejta hapsinore. Kontaktet e shkëmbimet e drejtpërdrejta në më të shumtën e rasteve ndodhin natyrshëm midis kulturash fqinje, por qëllimi i këtij studimi do të jetë përqasja e eposeve mesjetarë të dy popujve që kontaktet e drejtpërdrejta ndërmjet tyre, në periudhën kur këto krijime epike zunë fill, i kanë pasur relativisht të pakta. Kjo përqasje do të bëhet duke vënë përballë njëri-tjetrit eposin spanjoll *Kënga e Mio Sidit* dhe *Ciklin e Kreshnikëve*.

Në punim, synohet që të kryhet një krahasim duke u rrekur të prekim sa më shumë aspekte të dy eposeve, si dhe duke argumentuar mbi arsyet e ngjashmërive dhe ndryshimeve midis tyre. Krahasoni i këtyre dy krijimeve folklorike, njëri evropiano-perëndimor dhe tjetri ballkanas, do të përcillet përmes pranëvënies së dy kulturave, dy psikologjive, dy realiteteve mesjetare të këtyre rajoneve të Evropës, por njëkohësisht edhe duke pasur parasysh karakteristikat e eposit si lloj i epikës në vargje. Pra, do të kemi të bëjmë me një krahasim kryesisht tipologjik.

Fjalë çelës: Cikli i Kreshnikëve, epikë, evropian, krahasim, Mio Sid.

ABSTRACT

The similarities between the epics belonging to different European countries usually come as a result of direct spatial contacts. Direct contacts and exchanges in most cases occur naturally between neighboring cultures, but the purpose of this study will be to approach the medieval epics of the two peoples that have had relatively few direct contacts between them, in the period when these epic creations began. This approach will be made by juxtaposing the Spanish epic *The Song of Mio Cid* and the Albanian *Epic of Kreshnik*.

In this paper, it is intended to make a comparison by trying to touch as much as possible aspects of the two epics, as well as arguing on the reasons for the similarities and differences between them. The approach of these two folk creations, one Western European and the other Balkan, will be conveyed through the comparison of two cultures, two psychologies, two medieval realities of these regions of Europe, but at the same time considering the characteristics of the epic as a literary genre. So we are going to be dealing with a mostly typological comparison.

Keywords: comparison, epics, european, Kreshnik Epic, Mio Cid.

Ngjashmëritë ndërmjet eposeve që u përkasin vendeve të ndryshme europiane zakonisht vijnë si rezultat i kontakteve të drejtpërdrejta hapësinore. Kontaktet e shkëmbimet e drejtpërdrejta në më të shumtën e rasteve ndodhin natyrshëm midis kulturash fqinje, por qëllimi i këtij studimi do të jetë përjasja e eposeve mesjetarë të dy popujve që kontaktet e drejtpërdrejta ndërmjet tyre, në periudhën kur këto krijime epike zunë fill, i kanë pasur relativisht të pakta. Kjo përjasje do të bëhet duke vënë përballë njëri-tjetrit eposin spanjoll *Kënga e Mio Sidit* dhe *Ciklin e Kreshnikëve*.

Në punim, synohet që të kryhet një krahasim duke u rrekur të prekim sa më shumë aspekte të dy eposeve, si dhe duke argumentuar mbi arsyet e ngjashmërive dhe ndryshimeve midis tyre. Krahasimi i këtyre dy krijimeve folklorike, njëri europiano-perëndimor dhe tjetri ballkanas, do të përcillet përmes pranëvënies së dy kulturave, dy psikologji, dy realiteteve mesjetare të këtyre rajoneve të Evropës, por njëkohësisht edhe duke pasur parasysh karakteristikat e eposit si lloj i epikës në vargje. Pra, do të kemi të bëjmë me një krahasim kryesisht tipologjik.

Marrëdhëniet feudale në dy eposet

Eposi spanjoll *Kënga e Sidit* sjell një shprehje të gjallë të zhvillimit të marrëdhënieve feudale në Spanjë në periudhën e sundimit të mbretit Alfons VI. Sipas Gustavo Correa-s, marrëdhënia mbret-vasal te kjo poemë është e lidhur me temën e nderit dhe është pikërisht kjo temë që i jep qëndrueshmëri strukturës artistike të poemës.¹

Nëse vëzhgojmë vargjet e para të poemës, vërejmë se nderi i Sidit, është i lidhur me pasurinë materiale të dhënë nga mbreti. Me t'u internuar, Sidi humbet pasurinë dhe pendohet thellë për këtë humbje:

De los sus ojos tan fuerte mientras llorando,
Tornaba la cabeza y estábalos catando,
Vio puertas abiertas y uzos sin cañados,
Alcándaras vazías sin pieles y sin mantos
Y sin falcones y sin adtores mudados.²

Në heshtje teksa qante hidhërueshëm,
Ktheu kokën e po vështronte.
Pa dyer të hapura, që lëkundeshin pa brava,
varëse rrobash bosh, pa mantelë a pelerina,
Asnjë skifter a fajkua nuk vinte rrotull

1 Correa, Gustavo. “El Tema de la Honra en *El Poema del Cid*.” *Hispanic Review* XX, 1952: f. 185-199

2 Riaño Rodríguez, Timoteo & del Carmen Guitiérrez Aja, María. *El Cantar de Mío Cid (el manuscrito del cantar)*, Biblioteca virtual ‘Miguel de Cervantes’, pdf, f.13

Marrëdhënia mbret-vasal është e pranishme në të gjithë poemën dhe lidhet me konceptin mesjetar të nderit, mbreti është ai që i jep nderin vasalit. Një nder i tillë dëshmohet prej të mirave materiale dhe respektit shoqëror. Humbja e nderit nxit bëmat e Sidit, ndërsa besnikëria dhe nënshtrimi i tij ndaj mbretit e vënë atë në vend. Prandaj, nderi shërben si një lidhje midis mbretit dhe vasalit, falë tij Sidi ngrihet në kategorinë e heroit. Sidi është modeli shembullor i vasalit sepse ai arrin të rivendosë harmoni në marrëdhëniet e tij me mbretin, si dhe të përfitojë mirënjohje dhe favore që vijnë si rezultat i kësaj marrëdhënieje, ndërsa pushteti i mbretit rritet në territore dhe pasuri falë heroizmit të vasalit të tij besnik. Sidi, duke qenë një vasal i mirë, gjithashtu bëhet “zot” i çetës së tij, kështu që në poemë ilustron ideja se rruga e ngritjes shoqërore lidhet me nënshtrimin ndaj mbretit, pasi vetëm pranë tij rriten si nderi material, ashtu edhe ai moral.

Në *Ciklin e Kreshnikëve* vërejmë se kemi një shfaqje krejt të ndryshme të marrëdhënieve feudale. *Cikli* flet për luftëra kundër sllavëve. Heronjtë e eposit tonë janë në një konflikt të vazhdueshëm me krahinat feudale, madje mund të themi se krejt *Cikli i Kreshnikëve* përshkohet nga ky konflikt. Pothuajse në çdo këngë të *Ciklit të Kreshnikëve* kemi nga një duel, i cili në epos quhet “mejdani” ose “bejleg”, midis një kreshniku dhe një sllavi ose siç quhet ndryshe në rapsoditë tona “shkiu”, pra kemi si të thuash, një protagonist i cili është “kreshniku” dhe një antagonist që është “shkiu”.

Personazhet e eposit tonë nuk janë vasalë siç ndodh tek “*Kënga e Sidit*”. Muji dhe Halili ishin me të vërtetë prijësa mesjetarë shqiptarë, por ata na paraqiten më tepër si “cuba”, ose e thënë në një shkallë më të lartë si “harambashë” (turq.- kryetar hajdutësh), që kryejnë plaçkitje e rrëmbime vashash.

Tek “*Kënga e Cidit*”, luftohet për mbretin, por në luftën për mbretin përcillet gjithashtu dhe ideja e luftës për rritjen e madhësisë së Spanjës. Ndërsa në *Eposin e kreshnikëve*, ideja e atdheut është disi fluide. Tek kreshnikët nuk ekziston një vetëdije atdheu, por është sunduese vetëdija e bashkësisë, ndjenja e dallimit të “të vetëve” prej “të tjerëve”, kuptimi i të qenit ndryshe nga bota e madhe; aty kemi kultin e vendlindjes, të malit, të dheut, të bjeshkës, kultin e atij që konvencionalisht do ta quanim “atdhe shpirtëror”.

Konteksti, qëllimi final i këtyre dyluftimeve duket se është lufta për mbrojtjen e kufijve të trojeve shqiptare, për mbrojtjen e fisit, lufta për mbrojtjen dhe ruajtjen e kanunit dhe zakoneve që i lidhin njerëzit e maleve midis tyre dhe bëjnë që ata të mos humbasin identitetin.

Roli i personazheve femërore

Figurat e femrave janë gjithmonë të pranishme në eposet e popujve të ndryshëm. Ato zakonisht luajnë një rol të rëndësishëm në këto epose; janë ato që i japin dinamizëm subjektit të tyre. (p.sh. *Helena e Trojës* në eposin homerik, *Brynhilda* dhe *Ziglinda* tek eposi gjerman i Nibelungëve, etj).

Edhe në *Eposin e Kreshnikëve* figurat femërore zënë një vend të veçantë. Femrat më të rëndësishme për kreshnikët janë: nëna, motra, dhe nusja. Rrëmbimi i grave të familjes është shumë i i rëndë për ta, sepse cenon nderin e tyre.

Në *Ciklin e Kreshnikëve*, nëna e Mujit dhe e Halilit nuk na del kurrë me emër, ndërsa femrat e tjera kanë emra, kjo ndoshta sepse nëna është një, e vetme dhe e pazëvendësueshme. Ajo është thjesht “nana” e trimave dhe nuk ka nevojë për një emër të përveçëm. Emri i saj mund të jetë një emër çfarëdo, por ai nuk ka rëndësi. Duke e lënë si të thuash “anonime” nënën e trimave, figura e saj është lartësuar.

Një figurë tjetër e rëndësishme femërore është gruaja e Mujit Ajkunë ose Kune, por ngandonjëherë në eposin e shkurtër shqiptar Ajkunë quhet edhe motra e kreshnikëve, pra e Mujit dhe e Halilit. Ajo është një femër e fortë dhe besnike që i ndihmon kreshnikët.

Një e veçantë tjetër e *Ciklit të Kreshnikëve* janë ashtuquajturat “vajza burmesha”. Kemi një numër rapsodish në të cilat na paraqiten figura vajzash që janë trimëresha njëlloj si burrat, ato luftojnë nëpër bejlegë dhe mundin kundërshtarin. Këto vajza janë të gatshme të luftojnë deri në vdekje për të vënë në vend nderin, ato i presin kokën kundërshtarit pa ngurruar, njëlloj siç bëjnë edhe vetë kreshnikët. Heroinat e këtyre këngëve presin flokët tek berberi, vishen si burrat që të mos njihen nga kundërshtari dhe të trajtohen nga ai njëlloj si të ishin burra.

Tek eposi spanjoll *Kënga e Sidit*, personazhet kryesorë femra janë Himena, gruaja e Sidit, si dhe të bijat Elvira e Sol. Në poemë, si Jimena ashtu edhe vajzat, tregojnë dy anë të kundërta të karakterit të tyre, ato herë shfaqen si gra të ndjeshme dhe emocionale e herë të tjera tregojnë forcë përballë fatkeqësive.

Një nga boshtet kryesore të poemës është humbja e autoritetit prindëror mbi vajzat, ndarja e familjes dhe përpjekjet e heroit për ta ribashkuar atë. Sidi e humb familjen për shkak të internimit dhe, që në çastet e para të largimit, ai dëshmon se të bijat kanë përparësi për të. Si baba ai dëshiron që në të ardhmen t’i shohë ato të martuara më së miri.

Sidi çnderohet për shkak të vajzave të tij, të cilat pësojnë një fyerje të rëndë nga trashëgimtarët Carrion me të cilët ai i marton në mirëbesim, por, në mërgim, janë vajzat dhe e shoqja ato që bëhen viktimat si rezultat i internimit që pësoi Campeador-i (kupto kryeluftëtari, Campeador përdoret si sinonim i Sidit).

Ndër personazhet femra, Jimena, gruaja e Sidit, është ajo e cila, duke qenë e rritur, mund të shprehë qartë dhimbjen e familjes, pasi është edhe më e vetëdijshme për fatkeqësinë që pësojnë. Pas mërgimit të heroit, fabula merr një kthesë të papritur, pasi rolet ndryshojnë: ashtu si Sidi nuk është fajtor për mërgimin, por mërgimi i tij ndikon negativisht tek e shoqja, po ashtu as të bijat nuk meritojnë të vuajnë, por është për shkak të tyre që Campeador-i çnderohet rishtazi. Brenda një fabule të tillë, ku Jimena nuk është as viktimë dhe as nuk mund të kontribuojë në rikuperimin e nderit të humbur, personazhi i saj kalon në plan dytësor, derisa zhduket krejtësisht.

“Evoluimi i Sidit si personazh është i lidhur ngushtë me evoluimin e familjes së tij, dhe

veçanërisht me atë të të bijave. Nëse ndarja nga familja në mërgim dhe rimëkëmbja e saj tregon dy faza të kundërta të mërgimit, fillimi i tij dhe afërsia e faljes, fyerja që pësojnë të bijat çon në poshtërimin e Sidit, por njëkohësisht falë kësaj fyerje Sidi lidhet me shtëpitë mbretërore të Navarra-s dhe Aragoni-t. Prandaj, mund të themi se *Kënga e Sidit* është një poemë me veprim të dyfishtë, gjë që theksohet veçanërisht në rolin e femrave.”³ Të bijat e heroit kalojnë nga anonimia, në të pasurit e emrit të tyre, duke fituar protagonizmin e merituar në pjesën e dytë dhe duke shënuar nga ana tjetër kalimin e tyre nga vajza në gra. Dhe në këtë pikë, ato mund të zëvendësojnë zonjën e madhe të poemës, nënën e tyre.

Në të dy eposet femrat e familjes janë protagoniste dhe vënë në lëvizje ngjarjet. Cenimi i tyre shënon humbjen e nderit të heronjve.

Mitologjia pagane e Eposit të Kreshnikëve dhe mitologjia kristiane e Këngës së Sidit

Në çështjen e elementëve mitologjikë eposi spanjoll dhe eposi shqiptar kanë dallime thelbësore nga njëri-tjetri. Këto dallime kanë ardhur si rezultat i botëkuptimeve krejtësisht të ndryshme të dy popujve, atij spanjoll, si një popull perëndimor me një stad tjetër zhvillimi e qytetërimi në Mesjetë, dhe atij shqiptar, si një popull ballkanas që ende edhe sot ruan një botëkuptim arkaik.

Mitologjia e eposit shqiptar është një mitologji pagane. Figurat mitologjike në epos janë një trashëgimi e botës ilire. Në këtë grup bëjnë pjesë yjet dhe hëna që bëhen dorëzanë të heronjve kreshnikë: zanat dhe shtojzovallet, që u japin kreshnikëve fuqi mbinjerëzore; hyjnitë mbrojtëse të bjeshkëve, pyjeve dhe fateve njerëzore; vetë natyra me energjinë e saj çudibërëse.

Figurat qendrore të mitologjisë shqiptare janë zanat e malit. Me të drejtë rapsodia që paraqet takimin e parë të Mujit me zanat dhe marrjen e fuqisë prej tyre është cilësuar si kënga që hap artistikisht Ciklin e Kreshnikëve dhe mund të quhet rapsodia e shugurimit të këtij kreshniku si luftëtar bëmash të mëdha.

Mitet në eposin e kreshnikëve kanë karakter ktonik (tokësor) e matriarkal. Është e vështirë të gjenden në këngët e këtij cikli dëshmi perëndish qiellore ose nëntokësore, po ashtu është e vështirë të gjejmë hyjni patriarkale.

Duke u ndalur tek elementët mitologjikë të eposit spanjoll, vërejmë se aty është kapërcyer tërësisht faza e mitologjisë pagane e antike. Për Evropën perëndimore mesjetare monotesite, mitologjia pagane ku njeriu besonte në qenie të mbinatyrshme, konsiderohej si një fazë e zhvillimit të njerëzimit që tashmë ishte e largët.

3 Jovaní, Alfonso Boix. *Las mujeres del Cid: una respuesta a la variación onomástica de Elvira y Sol frente a la doble autoría del 'Cantar de Mio Cid'*, e Humanista, vol 34, 2016, f. 385

Por poema *Kënga e Sidit*, është një epos dhe në epos mitologjia është gjithmonë e pranishme, pavarësisht nëse zë një vend të rëndësishëm ose jo dhe pavarësisht se e ç’lloji është. Në eposin spanjoll nuk kemi mitologji pagane si tek *Cikli i Kreshnikëve*, por kemi mitologji kristiane. Aty shfaqen figura të mitologjisë kristiane siç është për shembull Kryeengjëlli Gabriel. Sidit i shfaqet në ëndërr kryeengjëlli në çaste vështira, ai e ngushëllon dhe gjithashtu profetizon se e gjithë rruga e tij do të jetë e suksesshme:

Allí se echaba mio Cid después de que cenó,
le embargó un sueño dulce, muy bien se durmió;
el ángel Gabriel en sueños le visitó:
—¡Cabalgad, Cid, el buen Campeador,
pues nunca en tan buen momento cabalgó varón!
Mientras vivas, lo tuyo saldrá a la perfección.⁴

*Aty ish shtrirë Sidi pas darke,
një gjumë i ëmbël e kaploi e fjeti thellë;
në ëndërr engjëlli Gabriel iu shfaq:
-Kalëroni, Sid, o kryeluftëtar i mirë,
kurrë një burrë nuk ka kalëruar në një çast kaq fatlum!
Për sa të jetoni, çdo gjë do t’ju shkojë mbarë.*

Pra kemi të bëjmë me ndërmjetësinë e rëndësishme të Kryeengjëllit Gabriel si lajmëtar i Zotit.

Në poemën spanjolle kemi kultin e perëndisë sipas mitologjisë kristiane. Uniteti i Atit, i Birit dhe i Shpirtit të Shenjtë janë trinia që përbën “njëshin”, perëndinë e vërtetë. Natyrisht, në ndryshim nga Cikli i Kreshnikëve, këtu flitet për perëndi qiellore, jotokësore, sepse i tillë konsiderohet Zoti në fetë monoteiste.

Tipet e heronjve epikë

Sipas tipit të heronjve, eposet mund t’i ndajmë në epose me mite legjendare dhe në epose me mite historike. Nëse në tipin e parë të eposeve, shfaqet mendësia e heronjve jotokësorë, që vijnë të rregullojnë fatin e kësaj bote dhe të ndreqin padrejtësitë e saj, në tipin e dytë zotërojnë mitet historike, krijimi i heronjve të mbifuqishëm prej njeriut vdekatar, lartësimi i individit të zakonshëm.

Eposi shqiptar është një epos që qëndron midis dy tipeve të mësipërm. Kreshnikët janë trima me fuqi mbinjerëzore. Ata paraqiten me veti gjysmë-hyjnore, gjysmë- tokësore.

4 Riaño Rodríguez, Timoteo & del Carmen Guitiérrez Aja, María. *El Cantar de Mío Cid (el manuscrito del cantar)*, Biblioteca virtual ‘Miguel de Cervantes’, pdf, f. 30

Heronjtë e eposit shqiptar, në thelbin e tyre ngjajnë më shumë me perënditë pagane të periudhës greko-romake, se sa me kalorësit trima të *Këngës së Sidi*. Fakti që eposi shqiptar qëndron midis dy tipeve të eposeve, flet për kohën e ndërmjetme të krijimit të tij, e cila duhet të gjendet midis antikitetit dhe Rilindjes Europiane.

Ndërsa eposi spanjoll është një epos i miteve historike. Sidi dhe heronjtë e tjerë të eposit francez janë të fuqishëm por jo të mbinatyrshëm; fuqia e tyre qëndron në kufijtë e njerëzores. Tek ky epos kemi të bëjmë me mitizimin e njeriut të zakonshëm. Heronjtë dhe ngjarjet e eposit spanjoll janë me burim të drejtpërdrejtë historik.

Natyra e vargut në dy eposet

Kur flitet për epose e për këngë epike një nga çështjet më të diskutuara ndërmjet studiuesve është natyra e vargut të tyre.

Cikli i Kreshnikëve është ndërtuar sipas sistemit tonik. Edhe poema *Kënga e Sidi* është ndërtuar mbi bazën e sistemit tonik të vargëzimit. Pikërisht këtu qëndron edhe një lidhje tjetër midis ciklit tonë dhe epepeve europiane, të cilat përgjithësisht janë ndërtuar mbi këtë sistem vargëzimi.

Vargjet e këngëve të Eposit të Kreshnikëve gjithashtu janë përgjithësisht pa rimë. Me gjasë mungesa e rimës është shenjë e vjetërsisë së tyre. *Kënga e Sidi* karakterizohet nga vargje që rimojnë përmes asonancës. Rima me asonancë lejon grupimin e vargjeve në strofa pak a shumë të gjata, që karakterizohen nga monorima. Këto strofa njihen me emrin “laisse” dhe janë tipike të eposeve kalorësiake europiane. Rima është një fenomen i ri në epos që duhet të ketë ardhur si rezultat i ndikimit të poezisë së kultivuar mbi të.

Për sa i përket strukturës strofike të këngëve tona epike, po të dëgjosh melodinë që i shoqëron, vihet re se ajo i bashkon vargjet në grupe. Siç e shohim për të grupuar vargjet e Eposit të Kreshnikëve në strofa melodike na vijnë në ndihmë formulimet epike hyrëse (*Lum për ty, o i madhi Zot/ që s’jem kanë Zoti na ka dhanë!*), mbyllëse (*Qeshtu thanë, atje nuk jam kanë, /Mos me kanë, nuk kishin thanë!*), por edhe ato që quhen formulësime të ndërmjetme (sërish me thirrje e lavde drejtuar Zotit).

Formulësime të përdora shpesh në epikën tonë janë edhe epitetet e vazhdueshme që u janë vënë heronjve, agallarëve të Jutbinës: Muji quhet Çetobasho Muji, Bylykbashe Muji; Baca Muji; Halili quhet Sokole Halili, Halil Aga i Ri; të tilla epitete janë kthyer ndonjëherë tek trimat në llagape: Ali Bajraktari, Zuku Bajraktar, Arnaut Osmani, Ganiqe Galani etj. Shumë dukuri apo objekte kanë epitetin e tyre të vazhdueshëm. Kështu hasim dendur: drita e bardhë, sabahi i bardhë, shpata e mejdanit, gjogu i bardhë, bjeshkët e nalta, etj.

Këto lloj formulësimesh janë të shpeshta edhe tek *Kënga e Sidi*, kështu Sidi përmes epiteteve të vazhdueshme cilësohet si: *Campeador (Luftëtari), Mjekra fisnike kaq e rritur, I linduri i mirë, Ai që ngjeshi shpatën në çastin e duhur, Ai që ka lindur me orë të mirë.*

Ndryshimi kryesor ndërmjet strukturave poetike të dy eposeve qëndron në atë që eposi spanjoll është organizuar me të njëjtën formë strofike si kur na jepet në formën e tekstit të shkruar ashtu edhe kur është i kënduar. Ndërkohë që këngët tona epike kur i studiojmë në formën e tyre të shkruar si tekst, na paraqiten në monokolonë, ndërsa kur i dëgjimë si këngë mund të bëjmë grupime në strofa melodike siç vërejtëm më sipër. Si *laisse-t* spanjolle, ashtu edhe grupimet tona melodike përbëhen nga një numër i ndryshueshëm vargësh. Në të dy eposet ka mjaft raste të së ashtuquajturës *repetitio epica*; vargje që janë shndërruar në formulësime të vërteta.

Këngët e eposit tonë të kreshnikëve janë rapsodi të veçanta të cilat mund të qëndrojnë edhe më vete në formë epesh të shkurtra. Tek *Kënga e Sidit* kjo nuk mund të ndodhë. Ajo është një poemë epike, zhanër i cili imponon një subjekt klasik, ku fabula ka një fillim, një pikëlidhje, një pikë kulmore, dhe një zgjidhje.

Përfundime

Duke iu referuar objektit tonë të studimit të këtyre çështjeve, pra përjasjes së *Eposit të Kreshnikëve* me eposin spanjoll *Kënga e Sidit*, është e rëndësishme të kemi parasysh se me gjithë ndryshimet që kanë të bëjnë me mënyra të ndryshme të perceptimit të botës dhe të marrëdhënieve njerëzore, eposi ynë dhe eposi spanjoll shfaqin shumë pikëtakime (diku më të largëta, diku më të afërta), pasi i përkasin të njëjtit lloj epik dhe mbi të gjitha janë pjesë e suazës së madhe të cikleve të vjetra paramesjetare e mesjetare të Europës.

BIBLIOGRAFIA

- Burke, James F. *La lógica de la imagen animal en el Cantar de Mio Cid*, Biblioteca virtual ‘Miguel de Cervantes’, Edición digital a partir de Actas del X Congreso de la Asociación Internacional de Hispanistas, 1989
- Correa, Gustavo. “El Tema de la Honra en *El Poema del Cid*.” *Hispanic Review* XX, 1952
- García Larraín, Federico. *El honor en el poema de Mio Cid*, Revista de Humanidades, no. 30, 2014
- Isufaj, Drita. Paralele mes Ciklit të Kreshnikëve dhe eposit francez ‘Kënga e Rolandit’ si pjesë e suazës së cikleve mesjetare e paramesjetare të Evropës, *Kultura popullore*, nr. 1-2, 2010
- Jakllari, Adem. *Ligjërata për Etnologjinë dhe Mitologjinë*, Albas, 2015
- Jovaní, Alfonso Boix. *Las mujeres del Cid: una respuesta a la variación onomástica de Elvira y Sol frente a la doble autoría del ‘Cantar de Mio Cid’*, eHumanista, vol 34, 2016
- Palaj, At Bernardin, Kurti, At Donat. *Visaret e Kombit I-XV* (i gjithë koleksioni), Arkivat digjitale, Shkodër
- Riaño Rodríguez, Timoteo & del Carmen Guitiérrez Aja, María. *El Cantar de Mio Cid (el manuscrito del cantar)*, Biblioteca virtual ‘Miguel de Cervantes’, pdf
- Sinani, Shaban. *Mitologji në Eposin e Kreshnikëve*, Naimi, 2015
- Zheji, Gjergj. *Folklor shqiptar*, Argeta LMG, 1998